



**VENDIM**

*Nr. 71, datë 27.05.2016*

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË  
KESH SH.A. PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË PRODHIMIT TË  
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR PERIUDHËN 1 KORRIK 2016 – 31  
DHJETOR 2016**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 21 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” neneve 18, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, vendimit nr. 77, datë 26.6.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”, VKM nr. 244, datë 30.03.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.05.2016, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a. për përcaktimin e tarifës për prodhimin e energjisë elektrike për periudhën 1 Korrik 2016 – 31 Dhjetor 2016, dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Çmimeve dhe Tarifave,

**Konstatohet se:**

- Aplikimi plotëson kryesisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a për periudhën 1 Korrik 2016 – 31 Dhjetor 2016.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të KESH sh.a. për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike për periudhën 1 Korrik 2016 – 31 Dhjetor 2016.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë KESH sh.a për vendimin e Bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.  
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE**  
**Petrit AHMETI**